

## Konkluzionet e përbashkëta për Rahovec

10 maj 2007

Udhëheqësit kyç të komunës së Rahovecit janë takuar së bashku sot për të konfirmuar vullnetin e tyre të mirë për bashkëpunim mbi çështjet sfiduese për komunën. Ky takim vjen në vazhdimësi të takimeve të mëhershme të përbashkëta dhe punëtorive për zgjidhjen e problemeve që janë kryer më herët nga CSSP-ja. Në vazhdim janë konkluzionet nga takimi i përbashkët i 10 majit 2007:

1. Të gjithë pranojnë se është arritur përparim në sferën e lirisë së lëvizjes, sigurisë së përgjithshme dhe kontakteve të përbashkëta ndërmjet afaristëve të të gjitha komuniteteve. Të gjithë e mbështesin dialogun e nisur ndërmjet komuniteteve dhe komunës në dialogun ndër-etnik lidhur me sfidat me të cilat ballafaqohet komuna e Rahovecit. Poashtu, të gjithë e mirëpresin punën e CSSP-së dhe konfirmojnë se takimet e përbashkëta dhe punëtoritë për zgjidhjen e problemeve i mbështesin përpjekjet për bashkëpunim të udhëheqësve kyç të Rahovecit.
2. Përbërja e kolegjit për intervistim për vendet e zbrazëta të punës në komunë është rishqyrtuar dhe tash përfaqëson një barazpeshë të mirë etnike dhe gjinore. Përshëndetet edhe përparimi i arritur në plotësimin e 17 vendeve të punës të hapur me dorëheqjen e punëtorëve serb në shtator 2006. Është me rëndësi që vendet e zbrazëta të plotësohen sa më shpejtë të jetë e mundur. Sugjerohet që së pari të bëhet një vlerësim i nevojave nga të dyja anët ashtu që pozitat të pasqyrojnë nevojat reale të komunës. Kryeshefi ekzekutiv pajtohet të takohet dhe të konsultohet me nënkryetarin shtesë, shefin e ZLK-së, dhe kryesuesin e komitetit për Komunitete për të diskutuar këtë çështje. Plani me shkrim duhet t'i parasheh hapat e ardhshëm.
3. Pozitat e përkthyesit për gjuhët serbe dhe shqiptare mbetet e hapur që prej më shumë se një viti. Kjo çështje duhet të zgjidhet menjëherë dhe të bëhet një prioritet më i lartë për t'i mbështetur përpjekjet në përmirësimin e raporteve ndër-etnike në Rahovec. Edhe pse është arritur marrëveshja që të përshpejtohet procedura e rekrutimit për pozitën e përkthyesit, nënkryetari shtesë pajtohet të identifikojë kandidatë të kualifikuar për pozitën e zbrazët.
4. Në mungesë të nënkryetarit shtesë duhet të sigurohet një përfaqësim adekuat i bashkësisë serbe në takimet komunale. Të gjithë janë pajtuar t'i dërgojnë ftesë shefit të komitetit për komunitete të merr pjesë në takimet e komitetit për politikë dhe financa si mysafirë në rast të mungesës së nënkryetarit shtesë. Nënkryetari shtesë do të iniciojë dialog me udhëheqësinë komunale, OSBE-në dhe UNMIK-un për të zhvilluar një koncept në mënyrë që zgjidhja t'i plotësojë të gjitha dispozitat ligjore.
5. Të gjithë e përshëndesin përmirësimin e punës së Komitetit për Komunitete pasi që tash ai takohet rregullisht. Për më tepër, të gjithë i nxisin anëtarët e Komitetit

për Komunitete që të bëjnë përpjekje të kenë më shumë rezultate në formë të rekomandimeve konkrete për zbatim nga Kuvendi Komunal. Kryesuesi i Komitetit për komunitete ose zëvendësi i tij duhet të marrin pjesë në të gjitha takimet e kuvendit komunal për të mbështetur dialogun ndërmjet kuvendit komunal dhe komitetit për komunitete.

6. Një prej problemeve të komitetit për komunitete është përpilimi i procesverbalit, përkthimi i dokumenteve dhe shpërndarja e dokumenteve për takim. Të gjithë u dakorduan se procesverbali mund të përpilohet në gjuhën serbe dhe më pastaj të përkthehet në gjuhën shqipe nga shërbimet komunale.
7. ZLK-ja është përgjegjëse për mbështetjen e Komitetit për Komunitete, përfshirë edhe mbajtjen e procesverbalit, përkthimin dhe shpërndarjen e dokumenteve. OSBE-ja ka ofruar tashmë trajnim fillestar për punëtorët e ZLK-së dhe ofron të mbajë edhe trajnime të mëturshme. ZLK-ja do të mbështet Komitetin për Komunitete duke filluar nga takimi i ardhshëm.
8. Çdokush i pranon vështirësitë e vazhdueshme lidhur me mbledhjen e pagesave për mbledhjen e mbeturinave në bashkësinë serbe. Pasi që është një proces që merr shumë kohë, është me rëndësi të gjindet një zgjidhje e përshtatshme për këtë çështje sa më shpejt të jetë e mundur. Si kryetari i Komitetit për Komunitete, ashtu edhe nënkryetari shtesë pajtohen të bëjnë përpjekje për të rritur vetëdijen e njerëzve për të filluar me pagesën e fakturave për mbledhjen e mbeturinave. Kryesuesi i Komitetit për Komunitete do ta vendos çështjen në rend të ditës në takimin e ardhshëm të Komitetit për Komunitete nga ku do të përgatiten rekomandime për takimin e Bordit të Drejtorëve. Nga anëtarët e bashkësisë serbe është sugjeruar shqyrtimi i angazhimit të një arkatari për të lehtësuar procesin e mbledhjes së fakturave ose të shqyrtohet mundësia e zbritjes direkte nga penzionet. Çështja e mbledhjes së fakturave do të ngritet në bordin e drejtorëve në njërin prej takimeve të ardhshme.
9. Pas suksesit të planit paraprak për integrim, të gjithë udhëheqësit kyç pajtohen se është me rëndësi të aprovohet një plan i ri i integrit dhe qëndrimit në Rahovec. Kryeshefi i ka kërkuar shefit të ZLK-së të përpilojë planin. Për të vlerësuar planin e veprimt, implementimin dhe afatet kohore do të themelohet një grup punues. Është sugjeruar që grupi punues të përbëhet prej 4 personave. Theks të veçantë duhet t'i vihet zhvillimit ekonomik të të gjitha komuniteteve.
10. Një prej problemeve të komunës është informimi publik dhe komunikimi i sukseseve të komunës popullatës së gjërë, për shembull mungesa e dijes mbi implementimin e suksesshëm të planit gjashtëmujor për integrim. Bordi i drejtorëve inkurajohet të diskutojë këtë temë dhe të zhvillojë disa opsione sesi të promovojë më tej punën e strukturave komunale.
11. Të gjithë pranojnë të bëjnë përpjekje për të nxitur aktivisht një atmosferë pozitive për kthim në fshatin Zoçishtë. Është me rëndësi thelbësore që të gjitha anët të nxisin kthimin dhe aspektet e tij pozitive. Të gjithë pajtohet të përqendrohen që kthimin të jetë i qëndrueshëm dhe të përmirësojnë më tej gjendjen e të gjitha komuniteteve në Rahovec.

12. Është fatkeqe që projekti i rrethimit të varrezave ortodokse ende mbetet i pazgjidhur përkundër diskutimeve të vazhdueshme vitin e kaluar për të zgjidhur problemin. Do të ishte fatkeqe nëse dështon projekti i OSBE-së për shkak se nuk mund të gjindet një zgjidhje kreative për këtë çështje. Poashtu është e rëndësishme thelbësore që të respektohet statusi i shenjtë i varrezave dhe të mos keqpërdoren. Qeveria komunale duhet të nxisë Shërbimin Policor të Kosovës që t'i dekurajojnë njerëzit t'i shfrytëzojnë varrezat për kullosën e kafshëve. Do të themelohet një grup punues për të identifikuar aspektet jo-kontraverze të projektit për të mundësuar zbatim sa më të shpejtë.
13. Të gjithë e kanë përsëritur vendimin e bordit të drejtorëve për të aprovuar fonde për transport si pjesë e projektit "Farat për të Ardhme më të Mirë" të inicuar nga Partners Kosova dhe nga USAID për dërgimin e një grupi multi-etnik të fermerëve në Maqedoni për vizitë në terren e shkëmbim të përvojave. Bordi i Drejtorëve është pajtuar të ofrojë fonde në shumë të njëjtë me atë të CSSP-së për të financuar transportin për këtë ngjarje.
14. Të gjithë e mirëpresin aprovimin e fondeve nga Agjencioni Austriak për Zhvillim për punëtorinë e zgjidhjes së problemeve për komunën dhe janë shprehur se punëtoritë e mëhershme ishin të dobishme dhe kanë kontribuar në përmirësimin e raporteve ndër-etnike ndërmjet komuniteteve në Rahovec. Është dakorduar që punëtoritë e fundit, e nivelit të tretë të mbahet prej 9 – 13 korrik 2007. Vendi i mbajtjes së punëtorisë do të jetë Strugë, Maqedoni.

*Konkluzionet e përbashkëta janë aprovuar me aklamacion verbal në takim me kusht që ato të shpërndahen pas përkthimit. Të gjithë të pranishmit mund të komentojnë deri më 30 maj 2007 ku pas kësaj konkluzionët konsiderohen të miratuara.*